

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Cela kërkon protestë për viktimat e pasluftës në Kosovë: Drejtësia duhet të vlejë për të gjithë
ADRESA	https://albeu.com/kosove/cela-kerkon-proteste-per-viktimat-e-pasluftes-ne-kosove-drejtesia-duhet-te-vleje-per-te-gjithe/1011575/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:11:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 19:08:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4c139e1e9c19f5e82d61857bf1389574a25fdb3ea97e8e73bd4f595539f52078
TEKSTI	b6724ae1e68427684b569dd245ba551854c1e6199bd3cafe693e815fdc05fb1c
PAMJA	ab9237a51c57342ce612bcb34931ceced6549d0820dbdb3e1e53929009b51464

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f6b36674ad76e80df11be853e929aea477cb2d5503ef9239d9d4eada7c8e2078
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f6b36674ad76e80df11be853e929aea477cb2d5503ef9239d9d4eada7c8e2078>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Cela kërkon protestë për viktimat e pasluftës në Kosovë: Drejtësia duhet të vlejë për të gjithë



Të mërkurën pritet të bëhet publik vendimi për ish-presidentin Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli e Jakup Krasniqi dhe ish-deputetin Rexhep Selimi, të cilët në Hagë përballen me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Aktakuza përfshin përndjekje, burgosje arbitrare, torturë, vrasje dhe zhdukje të detyruar.

Ndërkohë, në Prishtinë është zhvilluar të shtunën një tubim në mbështetje të të akuzuarve. Aktiviteti u organizua nga platforma "Liria ka emër".

Të hënën, platforma njoftoi se duke nisur nga 15 shtatori do t'i zhvendosë aktivitetet në Hagë. Atje, në bashkëpunim me diasporën shqiptare, do të mbahet aktiviteti "Nata e Pritjes".

Platforma ka shprehur shpresën se 16 shtatori, datë kur pritet të shpallet vendimi përfundimtar ndaj ish-krerëve të UÇK-së, do të shndërrohet në një ditë feste për Kosovën.

Ndërkohë, disa deputetë të Partisë Demokratike të Kosovës kanë bërë thirrje për armatosje. Disa prej tyre kanë deklaruar gjithashtu se, në rast dënimi, përgjegjësi duhet të mbajë edhe NATO.

Fehim Cela, një nga themeluesit e njësitit "Shqiponjat e Zeza", ka propozuar që vëmendja të përqendrohet edhe te viktimat e vrasjeve dhe krimeve të kryera pas luftës në Kosovë.

Në një deklaratë për gazetën "Bota sot", Cela tha se familjet e viktimave vazhdojnë të presin përgjigje për identitetin e autorëve, urdhëruesve dhe organizatorëve të këtyre krimeve, si dhe për personat që ndihmuan në mbulimin e tyre.

"Propozoj organizimin e një proteste në mbrojtje të viktimave të vrasjeve dhe krimeve të pasluftës në Kosovë, të gjithë atyre që u vranë, u plagosën ose u sulmuan dhe për të cilët, edhe pas shumë vitesh, e vërteta nuk është zbardhur dhe drejtësia nuk është vendosur."

të fundit /



Mes brirëve të demit 540 kilogramësh për mbi 10 sekonda, Roc...



Rodri: Barcelona duhet të jetë më e disiplinuar në mbrojtje



Mbyllen fjalimet para Kryeministrit, protestuesit marshojn...



Trump kundër ngadalësimit të AI-së: SHBA duhet të ruajë...



Avioni privat i nisur nga Holanda përplas në një fushë në Gjerman...



Liverpooli vëzhgon edhe Alejandro Balden pas marrëveshjes për...



iOS 27 mbërrin sot: Ja kur pritet të jetë i disponueshëm dhe ci...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Ka shumë raste që ende nuk kanë marrë përgjigje. Familjet vazhdojnë të kërkojnë të dinë se kush i vrau të afërmit e tyre, kush dha urdhrat, kush i organizoi krimet dhe kush ndihmoi që ato të mos zbardhen. Emrat dhe rastet janë të njohura, ndërsa historitë e tyre janë trajtuar ndër vite, por drejtësia ka munguar”, deklaroi Cela.

Sipas tij, protestat duhet t'u kushtohen edhe njerëzve që nuk kanë më mundësi të flasin dhe të kërkojnë vetë drejtësi.

“Në një periudhë kur po zhvillohen protesta e mobilizime në mbrojtje të personave të akuzuar apo të dyshuar për krime, duhet të dëgjohet edhe zëri i atyre që nuk mund të flasin më për veten: viktimave.

Duhet të kërkojmë drejtësi për njerëzit e vrarë padrejtësisht, për ata që u bënë objekt atentatesh, për familjet që humbën të dashurit dhe për të gjithë ata që u goditën për shkak të bindjeve të tyre politike, përkatësisë në një parti tjetër apo guximit për të menduar ndryshe”, theksoi ai.

Cela insistoi se tubimi duhet të ketë si qëllim drejtësinë dhe jo përfitimin politik, duke nënvizuar se viktimat nuk mund të përkujtohen vetëm në rastet kur kjo u shërben interesave të caktuara.

“Kjo nuk duhet të jetë një protestë kundër një partie ose në favor të një partie tjetër. Ajo duhet të jetë një protestë për drejtësinë dhe për parimin se asnjë vrasje nuk duhet të harrohet, ndërsa asnjë viktimitë nuk duhet të vlerësohet më pak për shkak të bindjeve politike.

Nëse kërkojmë drejtësi për krimet, ajo duhet të kërkohet për të gjithë. Nuk mund të ketë viktimë që kujtohen vetëm kur kjo na leverdis politikisht dhe viktimë të tjera për të cilat zgjedhim të heshtim.

Prandaj, duhet të organizohet një protestë për viktimat e pasluftës: për të vrarët, të plagosurit, personat ndaj të cilëve u kryen atentate dhe familjet që ende presin drejtësi. Mbi të gjitha, ajo duhet të jetë një protestë për të vërtetën që ende ua kemi borxh.

Pa drejtësi për viktimat, nuk mund të ketë paqe të plotë me të kaluarën”, përfundoi Cela.

Dhomat e Specializuara u krijuan nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2015, pas presionit të fuqishëm të aleatëve ndërkombëtarë. Ato veprojnë në Hagë në bazë të ligjeve të Kosovës, ndërsa trupi gjyqësor dhe prokuroria përbëhen nga zyrtarë ndërkombëtarë. Katër ish-drejtesit e UÇK-së ndodhen në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020.

Shtuar më 14.09.2026 21:08

Tags: [Çela](#), [protesta](#), [reagim](#)



Rustem Mustafa propozon “Koalicinin për Normalitet” për funksionalizimin e...



Gola: Lirimi i katër ish-drejtesve të UÇK-së do të ishte sukses i Kosovës, j...



Gjashtë projekte Kosovë-Maqedoni e Veriut marrin financim prej 3.24 milionë...



Vetëvendosje reagon pas largimit të Bekim Sejdiut nga gara presidenciale



Kurti takohet me ambasadorin Hargreaves, vlerësohet puna për...



Vjosa Osmani me vlerësim për Bekim Sejdiun pas tërheqjes nga gara për...



EULEX-i rishikon masat e sigurisë në Kosovë para vendimit të 16 shtatorit



Ilir Deda: Tërheqja e Bekim Sejdiut i kushtoi Kosovës një tjetër model...

